



Habib Zogaj
Drejtor
Radio Malisheva
R056
Malishevë

Ref:0706/0594/EXD/II

Prishtinë, 5 qershor 2007

VENDIM

lidhur me ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit dhe të frekuencës së Radio Malishevës.

Fakte

1. Më 5 prill 2007, Komisioni i Pavarur për Media (KPM) ka pranuar një ankesë nga Radio Malisheva për ndërhyrje në frekuencën 90.4 MHz nga Radio KFOR subjekt transmetues i cili transmeton në frekuencën 90.2 MHz, frekuencë që iu është ndarë në vitin 2003 nga Zyra e Komisionerit të Përkohshëm për Media atë kohë.
2. Sipas rezultateve të matjeve teknike nga inxhinieri i Divizionit të Menaxhimit Frekuencor (DMF) të KPM-së, ndërhyrjet që po i shkaktohen Radio Malishevës në frekuencën 90.4 MHz bëhen për shkak të pozitës gjeografike që e ka pika e Goleshit, prej nga Radio KFOR-i transmeton në frekuencën 90.2 MHz, dhe për shkak të llojit të sistemit të transmetimit të këtij subjekti transmetues.

Arsyimet

3. Në konsultim me inxhinierin e DMF-së të KPM-së, kemi ardhur në përfundim se mundësia e vetme për t'i ofruar zgjidhje Radio Malishevës është ndërrimi i frekuencës nga 90.4 MHz duke kaluar me transmetim në frekuencën 90.5 MHz. Gjithashtu, Radio Malishevës i lejohet ndryshimi i lokacionit të sistemit të transmetimit në vendin e propozuar nga ana e pronarit të këtij subjekti transmetues pasi që rezultatet e matjeve teknike të bëra nga DMF tregojnë se nuk do të ketë ndryshime në Pjesën 4 të licencës së Radio Malishevës.
4. Prandaj, DMF konstatoi se Radio Malishevës t'i lejohet transmetimin në frekuencën 90.5 MHz, pasi që është frekuencë e lirë për të transmetuar në Malishevë, dhe të ndryshojë lokacionin sipas koordinatave të përcaktuara nga DMF.
6. Më 1 qershor 2007, Radio Malisheva është pajtuar lidhur me propozimin e KPM-së për ndryshim të frekuencës, dhe njëkohësisht ka kërkuar që të bëjë ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit.

Vendim

7. Lejohet që Radio Malisheva të bëjë ndryshimin e frekuencës duke kaluar transmetimin nga frekuencia 90.4 MHz në frekuencën 90.5 MHz dhe të ndryshojë lokacionin e sistemit të

transmetimit në Qendrën Rinore dhe Tregtare Afariste "Dardania" në Malishevë sipas koordinatave të përcaktuara nga DMF.

8. Ky ndërrim i frekuencës së transmetimit dhe i ndryshimit të lokacionit të sistemit të transmetimit do të reflektojë vetëm në ndryshimin e Pjesës 2 të licencës, ndërsa zona e mbulimit do të mbetet e njëjtë ashtu siç është e përcaktuar në Pjesën 4 të licencës së Radio Malishevës.

Vërtetim

9. Me këtë KPM vërteton dhe lëshon këtë Vendim



Naile Selimaj Krashniqi,
Shefe Ekzekutive
Komisionit të Pavarur për Media



25.06.2007

Data